


Albanische Übersetzung des Merkblattes „In der Klasse Ihres Kindes hat es Kopfläuse!“ / Ausgabe 2021

## Fletudhëzim: „A ka morra në klasën e fëmijës suaj!“

### Më të rëndësishmet në pikë të shkurtërë

- Secilit nga ne mund t'i ndodhi të ketë morra në kokë – bashkërisht mund t'i largojmë përsëri.
- Reagimi i shpejtë pengon ngjitjen e tyre në mëdisin shkollor.
- **Diagnostikimi i morrave në kokë dhe mjekimi i tyre është çështje e prindërve.**
  - Kontrolloni ju lutemi që sot fëmijën tuaj dhe pjesëtarët tjerë të familjes (shih fig.poshtë).
  - Në qoftë se gjeni morra, trajtoni sipas udhëzimit të dhënë në faqen tjetër.
- **Fëmijët mund të vijojnë përsëri shkollën vetëm pas mjekimit me një ilaç kundër morrave.**

### Si duken dhe sa është kohëzgjatja e morrave



- **Vezët** („Thériyat“, nëse janë bosh) ngjiten fort në flokë. Ato duken njësoj si zbokth por prap nuk zhduken.
- Morrat kanë ngjyrën e njëjtë si të flokut dhe ikin nga drita. Me një kontrollë çasti në flokët e thata mund të shohim prezencën e morrave (shih poshtë).

### Mënyra adekuate e gjetjes së morrave dhe thërijave (kontrollohet krehja)

1. Flokët duhen lagur..
2. Jini dorëlirë në hedhjen dhe shpërndarjen e solucionit në flokët e lagura (i ashtuquajtur Conditioner).
3. Flokët e ngatërruara duhet krehur mirë (me brushë, me krehër).
4. Flokët duhet krehur që nga rrënja e deri tek maja.



Shembull: flokët e lagura krihen me krehër të morrave që nga rrënja deri në majë.

5. Krehja me krehër morrash duhet të bëhet mbi një letër të bardhë (psh. letër kuzhine), në mënyrë që të duken morrat dhe vezët.
6. Larja e flokëve duhet bërë me kujdes.

## **Skema e krehjes dhe mjekimit sipas gjendjes.**

Rregull e përgjithshme: **krehja 7 herë në 4 javë!** Mjekimi me ilaç morrash bëhet vetëm nëse janë shfaqur morra të gjallë.

Ilaçet e morrave me efekt të veçantë janë Hedrin dhe Paranix "Spray". Ilaçet dhe krehërit e morrave mund të merren në farmaci dhe drogeri. Gjatë shtatzënisë, dhënes gjii dhe tek fëmijët e vegjël duhet patur parasysh udhëzimin e paketimit.

Për informata të tjera në [www.gef.be.ch](http://www.gef.be.ch); [www.lausinfo.ch](http://www.lausinfo.ch).

### **Skema e krehjes dhe e mjekimit**

<b>Dita e 1-</b>	<b>Demonstrim: me krehër (shih faqen 1)</b> <b>A:</b> Nëse morrat janë tër pranishëm mjekohen dhe hiqen me <b>ilaç morrash</b> (psh. Hedrin dhe Paranix „Spray“). <b>B:</b> Nëse vetëm vezët/thërijet janë të pranishme, këto nxirren duke i krehur ( <b>pa ilaç morrash</b> ). <b>C:</b> Nëse nuk janë shfaqur morrat, vezët dhe thërijet, nuk ka nevojë për marrjen e masave të menjëherëshme (por duhet të bëhet kontrolli i krehjes pas 7 ditësh!)
<b>Dita e 3</b>	<b>A+B:</b> Morrat e mbetur dhe vezët/thërijet hiqen duke u krehur (kontrollohet krehja).
<b>Dita e 7</b>	<b>A:</b> Mjekimi i dytë me <b>ilaç morrash</b> heqja e morrave, vezëve dhe thërijave me anë të krehjes. <b>B:</b> Heqja e vezëve/thërijave ekzistuese (ose të reja) me anë të krehjes. <b>C:</b> Kontrollimi i krehjes
<b>Dita e 10</b>	<b>A+B:</b> Kontrollimi i krehejs
<b>Dita e 14</b>	- Në qoftë se edhe më tutje gjenden morra (ose dalin të rinj), duhet filluar me trajtim të ri. Në ditën e parë sipas skemës A „Mjekimi me ilaç morrash dhe krehje“. - Nëse nuk ekzistojnë morra, vezë/thërija mjekimi ka përfunduar.
<b>Dita e 21</b> <b>Dita e 28</b>	Për shkak të mundësisë së bartjes së morrave, edhe gjatë dy javëve të tjera duhet të vazhdohet me kontrollimin e krehejs (1x në javë).

**Në qoftë se edhe pas trajtimit dyjavor me Hedrin gjendne morra ju lutemi të paraqiteni tek specia-listi , i cili do t'ju jap këshillat e nevojshme!**

### **Këshilla të rëndësishme**

- Ju lutemi që në rast të shfaqjes së morrave dhe të parandalimit të përhapjes së tyre të informoni sa më shpejt rrëthin tuaj, shkollën, kopshtin, miqtë etj.
- 1 herë në javë të bëhet kontrollimi rrëth morrave tek të gjithë **pjesëtarët e familjes**.me anë të krehërit të morrave.
- Krehërit, brushat e flokëve të mbahen 10 minuta në ujë sapuni të nxehtë(60° C).
- Flokët e gjata të lidhen (lidhja direkte e flokut me flokun).
- Masat tjera nuk janë të domosdoshme. Përqëndrohuni në kokë.
- Parandalimi më i mirë tek fëmijët është 1 herë në javë larja (i ashtuquajtur Conditioner) e flokëve dhe krehja etyre sa janë të lagura me krehë morrash në formë kontrolli që të kafen me kohë

Për pyetje në dispozicionin tuaj është: